



Tirana bëhet skena e botës: Kanye West sjell një super-spektakël historik në Shqipëri

Tirana është gati të përjetojë një nga momentet më të mëdha në historinë e saj kulturore dhe artistike. Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit ka kënaqësinë të ndajë lajmin për organizimin e një prej ngjarjeve më spektakolare muzikore ndërkombëtare të zhvilluara ndonjëherë në Shqipëri, që do të mbahet më 11 korrik 2026. Artisti me ndikim global Ye do të ngjitet në skenë për një performancë unike “one-night-only”, duke sjellë në vendin tonë një produksion gjigand, të standardeve më të larta botërore.

Si një nga artistët më ndikues të kohës sonë, Ye ka formësuar për mbi dy dekada muzikën, modën dhe kulturën globale. Diskografia e tij përfshin albume ikonike si The College Dropout, Graduation, 808s & Heartbreak dhe Donda, të cilat dëshmojnë një evolucion të vazhdueshëm artistik dhe një kërkim të pandërprerë për forma të reja shprehjeje. I njohur për qasjen e tij novatore dhe performancat që sfidojnë kufijtë e zhanreve, ai vazhdon të rishkruajë standardet e spektaklit live në skenën ndërkombëtare.

Eventi do të zhvillohet në një hapësirë të dedikuar enkas për këtë performancë – Eagle Stadium, një stadium i përkohshëm me kapacitet prej rreth 60,000 spektatorësh, i ndërtuar në Kashar, përgjatë aksit Tiranë–Durrës.

Ky projekt përfaqëson një investim të rëndësishëm në infrastrukturën e eventeve dhe shënon një hap të ri për pozicionimin e Shqipërisë si destinacion për ngjarje të mëdha artistike dhe kulturore.

Prania e tij në Tiranë përbën jo vetëm një moment të rëndësishëm për publikun shqiptar, por edhe një mundësi të jashtëzakonshme për të rritur profilin ndërkombëtar të vendit përmes industrisë së eventeve dhe turizmit kulturor. Ky aktivitet i përmasave të mëdha pritet të gjenerojë ndikim të drejtpërdrejtë në ekonominë lokale, duke nxitur turizmin, rritur vizibilitetin



ndërkombëtar dhe krijuar mundësi të reja bashkëpunimi për profesionistët e industrive kreative dhe të eventeve në Shqipëri.

Organizimi i koncertit realizohet nga kompania ndërkombëtare Streetlife, në bashkëpunim me Redcloud të cilët do të mbështesin realizimin në terren të këtij eventit në Tiranë.

Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit vlerëson nisma të tilla që kontribuojnë në zhvillimin e industrisë së eventeve, fuqizimin e turizmit dhe promovimin e Shqipërisë si një qendër e re për aktivitete kulturore dhe artistike në rajon dhe më gjerë.

yealbania.com